



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Të sfiduara, por të qëndrueshme

Situata e organizatave
të grave në Kosovë

Përmbledhje ekzekutive

Përballë një situatë gjeopolitike që ndryshon me shpejtësi dhe një klimë financimi gjithnjë e më sfiduese, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) realizoi anketime ballë për ballë me 103 organizata të ndryshme të shoqërisë civile për të drejtat e grave (OShCG) në Kosovë, për të vlerësuar gjendjen e tyre aktuale.¹ OShCG-të e anketuara përfaqësojnë interesat e grave të të gjitha etnive, moshave dhe me aftësi të ndryshme në zonat rurale dhe urbane.

Gjetjet kryesore

- Mjedisi që mbështet funksionimin e shoqërisë civile në përgjithësi përputhet me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por përmirësimet në fushën e filantropisë, vullnetarizmit dhe kornizës financiare mund të lehtësojnë qasjen OShC(G)-ve në burimet.
- Udhëzimi administrativ mbi partneritetin publik-privat nuk është miratuar, dhe nuk ekziston ndonjë linjë buxhetore shtetërore e dedikuar për mbështetjen e OShC(G)-ve. Kornizat rregullatore që rregullojnë taksat, donacionet dhe vullnetarizmin kërkojnë përmirësim.
- [Të dhënat](#) tregojnë se OShCG-të kanë qenë faktor shtytës i arritjeve kyçe drejt një demokracie gjithëpërfshirëse, qeverisjeje të mirë, sundimit të ligjit, qasjes në drejtësi dhe të drejtave të njeriut, duke kontribuar gjithashtu në avancimin e Kosovës në rrugën e saj për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE).
- Pavarësisht rolit të tyre të rëndësishëm, OShCG-të janë nën kërcënim përball ndryshimeve globale në tendencat e financimit. Disa donatorë dypalësh dhe fondacione private kanë reduktuar ndjeshëm ndihmën e tyre dhe në mënyrë të papritur. Prioritetet e ndryshueshme janë të dukshme edhe në BE.
- Në dy vitet e fundit, 40% e OShCG-ve raportojnë se financimi ka pësuar ulje.
- 59% e OShCG-ve nuk kishin asnjë të ardhur për vitin 2026, ndërsa vetëm 9% kishin fonde të siguruara për vitin 2027 dhe më tej.
- Më shumë se 22 punonjës janë pushuar nga puna dhe të paktën 49 aktivistëve u janë reduktuar orët e punës.
- Reduktimet në financim kanë sjellë ulje të shërbimeve, mbështetjes për fuqizimin ekonomik të grave, përpjekjeve për avokim dhe monitorim, ngritjes së vetëdijes, arsimit dhe hulumtimit. Gjithashtu, kjo situatë ka kontribuar në stres, pasiguri dhe djegie profesionale mes aktivistëve.
- Në të kaluarën, 81% e OShCG-ve kanë marrë mbështetje nga institucionet e Kosovës, megjithëse kontratat mesatare zgjatnin më pak se pesë muaj. Ekziston mundësia për përmirësimin e kësaj mbështetjeje.
- Duke dëshmuar qëndrueshmërinë dhe shpirtin aktivist të aktivistëve për të drejtat e grave, 91% deklaruan se do të vazhdojnë punën e tyre edhe pa financim nga donatorët, pavarësisht sfidave të lidhura me këtë.

Rekomandimet kryesore

- **Për Qeverinë e Kosovës:** Të ndahen urgjentisht fonde të mjaftueshme për të mbështetur plotësisht shërbimet e specializuara të ofruara nga OShCG-të, veçanërisht në mungesë të shërbimeve shtetërore, duke përdorur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor për të vlerësuar saktë kostot vjetore. Në Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2025-2035 të përfshihen zotime dhe objektiva të qarta për financim afatgjatë dhe cilësor nga qeveria për

¹ RrGK ka kryer këtë studim duke përdorur burimet e veta të kufizuara, përfshirë mbështetjen institucionale nga Sigrid Rausing Trust, Fondacioni Kvinna till Kvinna dhe UK International Development. Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësi vetëm e RrGK-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e fondacionit Kvinna till Kvinna apo të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. RrGK falënderon OShCG-të që kontribuan me kohën e tyre të vlefshme, pa pagesë, për të marrë pjesë në këtë anketë. Falënderime të veçanta për stafin e RrGK-së që punoi shumë për ta bërë të mundur këtë dokument.

OShCG-të e ndryshme, në përputhje me Agjendën për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS). Të përmirësohen kornizat ligjore dhe mjedisi mundësues për funksionimin e OShC(G)-ve të ndryshme, në mënyrë që të mund të mbledhin fonde nga individët dhe bizneset dhe të angazhojnë vullnetarë.

- **Për donatorët ndërkombëtarë:** Të vazhdohet me ofrimin e financimit fleksibël dhe afatgjatë, përfshirë mbështetjen institucionale, veçanërisht për institutet e hulumtimit, organizatat mbikëqyrëse dhe OShCG-të që kanë në fokus avokimin, në mënyrë që ato të mbeten të pavarura për të siguruar llogaridhënie nga Qeveria, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazinë gjinore, qeverisjen e mirë, demokracinë, qasjen në drejtësi dhe shoqërinë civile të pavarur. Të përdoret një “koktej” i mbështetjes institucionale, grante projektesh dhe nën-grante për OShCG-të më të vogla, për të adresuar nevojat e ndryshme të tyre.



Mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile

Në Kosovë, mjedisi që mbështet funksionimin e shoqërisë civile (p.sh., liria e asociimit, tubimet paqësore dhe liria e shprehjes) është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.² Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2024 vuri në dukje rolin aktiv të shoqërisë civile në zhvillimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e reformave lidhur me anëtarësimin në BE.³ Raporti theksoi se qeveria e lehtëson këtë rol duke siguruar qasje në projektligje dhe politika përmes platformës online për konsultim publik. Megjithatë, raporti vuri në dukje se konsultimet mbeten të pamjaftueshme, pasi janë të organizuara dobët, mungon angazhimi i hershëm i shtetit dhe shoqërisë civile i jepet kohë e pamjaftueshme për të dhënë një kontribut të vërtetë dhe të rëndësishëm. Raporti përmendi veçanërisht se OShC-të për personat me aftësi të kufizuara dhe OShCG-të nuk përfshihen sistematikisht. Në këtë raport u theksua gjithashtu nevoja e Qeverisë për përmirësimin e kornizës së financimit për OShC-të.

Edhe pse korniza për shpërndarjen e fondeve publike për OShC-të është në përputhje me standardet ndërkombëtare, zbatimi i saj mbetet sfidues.⁴ Thirrjet publike zbatohen në mënyrë jo të qëndrueshme nëpër institucionet e ndryshme, dhe detyrimet për raportim nuk përshtaten me kapacitetin e OShC-ve, duke krijuar barrë të panevojshme për organizatat me burime të kufizuara. Niveli i financimit publik për OShC-të ra në vitin 2024 në rreth 8.6 milionë euro, nga 14.4 milionë euro në 2023 dhe 29.3 milionë euro në 2021.⁵ Kjo ulje ka ngritur shqetësime lidhur me parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e mbështetjes për shoqërinë civile, veçanërisht për shkak të mungesës së mekanizmave për financim emergjent ose financim të shkallës së vogël.⁶

Sipas raportit të fundit të Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) për vitin 2024, “sektori i shoqërisë civile në Kosovë vazhdon të demonstrojë qëndrueshmëri dhe angazhim, pavarësisht pasigurisë financiare në rritje dhe pengesave ligjore.”⁷ Raporti vuri në dukje rolin thelbësor të shoqërisë civile në “parandalimin e ligjeve të dëmshme.” Megjithatë, u theksua se “këto arritje mbeten të cenueshme pa financim të vazhdueshëm, pjesëmarrje aktive dhe mekanizma të fortë mbrojtës. Adresimi i këtyre boshllëqeve është thelbësor për të ruajtur llogaridhënien demokratike, për të nxitur angazhimin qytetar dhe për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit.”

Për organizatat e grave, anëtarët dhe përfituesit e tyre

OShCG-të luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e pabarazive midis grave dhe burrave të ndryshëm në mbarë botën, përfshirë Ballkanin Perëndimor (BP) dhe Kosovën. Siç kanë treguar hulumtimet e mëparshme të RrGK-së, OShCG-të janë “agjente të ndryshimit, mbrojtëse, ofruese shërbimesh, hulumtuese, mësuese dhe ekspertë që kanë kontribuar ndjeshëm në ndryshime sociale, politike, ligjore, ekonomike dhe individuale brenda vendeve të tyre dhe më gjërë.”⁸ OShCG-të kanë ofruar dhe vazhdojnë të:

² Anja Bosilkova-Antovska dhe Simona Mladenovska, [Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development – Regional Report: Western Balkans and Türkiye 2024](#) [Matrica e monitorimit për mjedisin mundësues të zhvillimit të shoqërisë civile – Raporti rajonal: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2024] 2025, f. 21. Ato vunë re se masat ligjore dhe rregullatore të prezantuara në vitin 2024 për zbatimin e ligjit për lirinë e asociimit ngritën disa shqetësime.

³ Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, 2026, f. 8.

⁴ Po aty., f. 16.

⁵ Po aty., f. 16.

⁶ DG ENEST Guidelines for EU Support to Civil Society in the Enlargement Region: 2024 Assessment: Report for Kosovo [Udhëzime për mbështetjen e BE-së ndaj shoqërisë civile në procesin e zgjerimit: Vlerësimi 2024: Raporti për Kosovën], DG ENEST.

⁷ BCSDN, [Monitoring Matrix Kosovo report](#) [Raporti i matricës së monitorimit për Kosovën], 2024. RrGK nuk ka mundur të gjejë hulumtime më të reja mbi situatën e shoqërisë civile në Kosovë gjatë rishikimit të shpejtë të burimeve online.


⁸ Si shembull, shih RrGK, [Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor](#), 2020.

- ofrojnë mbështetje psikologjike, shërbime shëndetësore, mbrojtje, ndihmë ligjore dhe fuqizim për gratë dhe fëmijët e prekur nga dhuna, duke avancuar **qasjen në drejtësi dhe sundimin e ligjit**
- kontribuojnë në **qeverisje të mirë** dhe **demokraci** përmes ekspertizës së tyre dhe duke ushtruar presion publik për miratimin e ligjeve dhe politikave të rëndësishme që mbrojnë gratë, fëmijët dhe personat LGBTQI+, përfshirë edhe ato që lidhen me adresimin e dhunës me bazë gjinore, të drejtat e punës, kundër diskriminimit, barazinë gjinore, buxhetimin më të mirë, anëtarësimin në BE dhe të tjera
- ndërtojnë paqe përtej barrierave etnike dhe kombëtare dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në Agjendën GPS
- ofrojnë ndihmë humanitare, arsim dhe shërbime shëndetësore për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitete të ndryshme etnike
- fuqizojnë më shumë gra të profileve/grupeve të ndryshme për të hyrë në politikë dhe vendimmarrje në të gjitha nivelet, duke forcuar **demokracinë**
- kryejnë hulumtime që mbështesin hartimin e ligjeve, politikave, si dhe arsimin dhe mediat, bazuar në fakte
- kontribuojnë drejtpërdrejt në zbatimin e Planit të Veprimit Gjinor III të BE-së dhe në proceset e **anëtarësimit në BE** nga perspektiva gjinore, duke ofruar ekspertizë, monitorim, hulumtim dhe avokim, si partnerë kyç të BE-së për avancimin e **vlerave themelore** të saj
- shërbejnë si organizata mbikëqyrëse, duke kërkuar llogaridhënie nga qeveritë dhe sistemet e drejtësisë përmes monitorimit, avokimit, ndihmës ligjore dhe veprimeve ligjore strategjike, dhe duke kontribuar kështu në progresin e reformave lidhur me anëtarësimin në BE
- ofrojnë **shërbime thelbësore**, veçanërisht kur institucionet shtetërore nuk mund të reagojnë ose kur shërbimet janë ndërprerë ose ende nuk janë institucionalizuar.

Siç tregon Grafiku 1, OShCG-të janë të shpërndara në të gjithë Kosovën.⁹ Disa veprojnë në tërë vendin, pavarësisht selisë qendrore. Në vitin 2024, OShCG-të shërbyen rreth **152,000 përfitues**. Në vitin 2025, ato kishin rreth 10,404 **anëtarë aktivë**, mesatarisht 101 për organizatë. Ato angazhuan gjithsej 740 punonjës (mesatarisht shtatë për organizatë), prej të cilëve 64% ishin të paguar. Për më tepër, OShCG-të angazhuan 752 vullnetarë.


Siç tregon Grafiku 2, OShCG-të fokusohen në një sërë çështjesh, përfshirë fuqizimin ekonomik të grave (63%); adresimin e dhunës gjinore, përfshirë dhunën seksuale gjatë luftës (49%); shëndetin e grave dhe vajzave (41%); qasjen në arsim, përfshirë arsimin informal dhe atë të vazhdueshëm (32%); të drejtën për tokë, pronë dhe trashëgimi (27%); të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (24%); udhëheqjen, fuqizimin dhe angazhimin politik të grave (21%); artin dhe kulturën (17%); ndërtimin e paqes dhe drejtësinë tranzicionale (17%); të drejtat dhe shëndetin seksual (16%); demokracinë dhe qeverisjen, përfshirë monitorimin dhe sigurimin e llogaridhënies së qeverive (14%); fuqizimin e të rinjve (13%); të drejtat e punëtorëve (13%); ndihmën humanitare dhe emergjente (10%); mbrojtjen e mjedisit dhe drejtësinë (9%); punën dhe shërbimet sociale (6%); gratë në media (6%); trafikimin e njerëzve (6%); të drejtat e pakicave dhe integrimin (4%); të drejtat e personave LGBTQIA+ (4%); të drejtat e të moshuarve (3%); ndihmën ligjore (>3%); migracionin (3%); integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE (3%); zotësinë digjitale (1%); dhe pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në sport (1%). OShCG-të zakonisht punojnë mbi disa çështje njëkohësisht dhe synojnë grupe të ndryshme dhe të larmishme.

Grafiku 1. Vëndndodhja e OShCG-ve



⁹ E kryer gjatë periudhës gusht 2025 – janar 2026, kjo anketë u bazua në [metodologjinë](#) e Shoqatës për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID). Anketa u përshtat për t'u përdorur në intervista pak më të shkurtra, ballë-për-ballë ose online, me qëllim përfshirjen e OShCG-ve shumë të larmishme që mund të mos kishin qasje në anketën online. Ndër pjesëmarrësit ishin si anëtarët të RrGK-së ashtu edhe OShCG-të që nuk janë anëtare e që punojnë në zona rurale (49%) dhe me persona me aftësi të kufizuara (12%). Gjashtë OShCG të anketuara drejtohen nga komuniteti serb, ndërsa disa të tjera punojnë me përfitues nga të gjitha përkatësitë etnike. Kjo anketë mund të konsiderohet përfaqësuese për popullsinë e OShCG-ve në Kosovë, pasi pothuajse të gjitha OShCG-të aktive morën pjesë, me pak përjashtime (kryesisht për arsye shëndetësore ose për shkak të mosaktivitetit).

Grafiku 2. Fushat kryesore të veprimit të OShCG-ve
(% dhe # i OShCG-ve)



Në të ardhmen, OShCG-të u shprehën se RrGK-ja duhet të përqendrohet në fushat prioritare të paraqitura në Grafikon 3. Këto mund të konsiderohen si prioritetet e lëvizjes së grave në Kosovë, pasi janë mbështetur nga disa OShCG. Për më tepër, ato bazohen në të dhëna që evidentojnë pabarazitë kryesore që kërkojnë të adresohen në Kosovë.

Grafiku 3. Fushat në të cilat RrGK duhet të fokusohet në të ardhmen
(% dhe # i OShCG-ve)



Në përgjithësi, 77% e OShCG-ve thanë se duhet të përqendrohet vëmendja te fuqizimi ekonomik i grave, përfshirë ndryshimet në ligjin e punës; 58% te adresimi i dhunës me bazë gjinore; 49% te përmirësimi i qasjes së grave në shërbime shëndetësore cilësore; 45% te gratë,

paqja dhe siguria; 39% te buxheti i përgjegjshëm gjinor; 32% te arsimit transformues gjinor, përfshirë qasjen në arsim; 29% te fuqizimi dhe zgjerimi i lëvizjes feministe; 27% te pjesëmarrja politike e grave; 26% te ndryshimet klimatike nga perspektiva gjinore; dhe 20% integrimi i perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE. Disa OShCG theksuan gjithashtu rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme për të rinjtë, të moshuarit, gratë në zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë nga komunitetet pakicë.

Situatë e ndryshueshme e financimit

Në janar 2025, vendimi i papritur i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për të pezulluar ose përfunduar financimet globalisht ka rritur cenueshmërinë e shoqërisë civile, përfshirë Kosovën. Hulumtimi i shpejtë i [Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile](#) (KCSF) vlerësoi se reduktimet e financimit nga USAID pezulluan 28 milionë euro në 68 kontrata të OShC-ve në Kosovë.¹⁰ Anketa e shpejtë e RrGK-së në fillim të vitit 2025 konstatoi se të paktën 11 OShC të Kosovës që fokusohen në avancimin e të drejtave të grave të profileve/grupeve të ndryshme humbën ose kishin gjasa të humbnin financime në vlerë mbi 1.25 milionë euro. Mesatarisht, ky financim përbënte rreth 46% të buxheteve të këtyre OShC-ve për vitin 2025. Reduktimet e financimit vunë në rrezik jetë njerëzish (p.sh., për shkak të dhunës ose mungesës së kujdesit shëndetësor); ulën sigurinë e aktivistëve; kontribuan në humbjen e qasjes së grave të mbështetja ekonomike, programet e fuqizimit dhe shërbimet si strehimi ose këshillimi; dhe reduktuan përpjekjet për avokim, mbikëqyrje, ngritje të vetëdijes, arsim, hulumtim, monitorim, vlerësim dhe mësim. Reduktimet ndikuan negativisht në programet që lidhen me adresimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë edhe dhunën kibernetike; sundimin e ligjit, ndihmën ligjore dhe qasjen në drejtësi; angazhimin ekonomik të grave dhe të drejtat e punës; ndërtimin e koalicioneve; avokimin për politika; gratë, paqen dhe sigurinë; programet arsimore; të drejtat e grave nga pakicat; të drejtat LGBTQI+; shëndetin riprodhues; të drejtat e grave me aftësi të kufizuara; pjesëmarrjen politike të grave; dhe programet mjedisore të ndjeshme ndaj aspektit gjinor. Më shumë se 22 punonjës janë larguar nga puna dhe 49 aktivistë/mbrojtës të të drejtave të njeriut raportuan ulje të orëve të punës. Reduktimet kanë kontribuar në stres dhe/ose shterim profesional të aktivistët.

Që nga ajo kohë, disa donatorë të tjerë dypalësh kanë reduktuar ndihmën e huaj në mënyrë të konsiderueshme, duke përkeqësuar kështu situatën. Goditja e fundit më e madhe për OShCG-të ishte vendimi i përgjithshëm i Qeverisë Suedeze për të ndërprerë të gjithë programet rajonale. Ky vendim detyroi Fondacionin Kvinna till Kvinna të përfundonte papritur mbështetjen

“

Kjo do të minojë drejtpërdrejt demokracinë, duke tkurrur hapësirën për shoqërinë civile dhe duke heshtur ose duke zbutur zërat e organizatave për të drejtat e grave. Disa mund të detyrohen të mbyllën ose të ndalojnë përkohësisht aktivitetet, ndërsa organizatat më të forta përpiqen të riorganizohen dhe të mbulojnë shpenzimet bazë, gjë që ua merr kohën dhe fokusin nga aktivitetet tona për monitorim, mbikëqyrje dhe avokim, përfshirë ofrimin e ekspertizës në grupet punuese, mbi projektligje dhe politika... të cilat janë po aq të rëndësishme për proceset demokratike dhe për reforma cilësore lidhur me BE-në.

- Aktiviste për të drejtat e grave

”

¹⁰ Gjetjet e përgjithshme nuk mund të gjendeshin më online. GAP gjithashtu ka bërë [hulumtime](#) dhe ka paraqitur shifra më të larta, pasi kishte përfshirë projekte që ishin pothuajse të përfunduara dhe që ishin përtej sektorit të shoqërisë civile.

për 15 OShCG në BP, përfshirë tre nga Kosova. Programi rajonal mbështeste ofrimin e shërbimeve, ndërtimin e paqes, angazhimin qytetar dhe mbikëqyrjen e procesit të anëtarësimit në BE nga OShCG-të. Ndërkohë, Belgjika planifikon të ulë ndihmën e huaj për 25% gjatë pesë viteve të ardhshme; Mbretëria e Bashkuar e ka reduktuar për 40%, Franca me 37%, Gjermania për 27% dhe Holanda për 30%. Është shqetësuese që Qeveria Holandeze njoftoi për planet për të reduktuar financimin për organizatat joqeveritare (OJQ-të) për më shumë se 70% gjatë periudhës 2026–2030 dhe për të ndërprerë mbështetjen për avancimin e barazisë gjinore.¹¹ Disa fondacione private gjithashtu kanë përfunduar ose reduktuar mbështetjen për të drejtat e grave. Edhe pse ulja e buxhetit të ndihmës mund të lidhet me rritjen e ideologjive politike të djathta, skepticizmin në rritje ndaj ndihmës ndërkombëtare dhe uljen e besimit në efektivitetin e sistemeve të ndihmës,¹² kjo i atribuohet më gjerësisht ndryshimit të interesave dhe prioriteteve strategjike të donatorëve, veçanërisht rishpërndarjes së burimeve publike drejt sigurisë dhe mbrojtjes në kontekstin aktual gjeopolitik.

Ndryshimet e prioriteteve janë gjithashtu të dukshme në BE, e cila mbetet donatori më i madh për BP-në. Korniza e propozuar shumëvjeçare financiare (KShF) për 2028–2034 – buxheti i BE-së – synon të [kanalizojë burime shumë më të mëdha](#) drejt sigurisë, mbrojtjes dhe konkurrencës, krahasuar me KShF-në aktuale. Instrumentet e financimit të BE-së për zhvillim global do të shkrihen me ato që mbështesin anëtarësimin në BE dhe me fondet e ndihmës humanitare, në një instrumenti të ri “Global Europe”, i cili vë theks më të madh mbi avancimin e interesave strategjike të BE-së.¹³ Ky ristrukturim do të shoqërohet me ndryshime të dukshme të propozuara në modalitetet e financimit: uljen e objektivit të shpenzimeve për ndihmën zyrtare për zhvillim nga 93% në 90%; rritjen e pjesës së financimit jo-programues në veprimet e jashtme, duke eliminuar programet tematike të mëparshme për projektet e veçanta, përfshirë ato të dedikuara për të drejtat e njeriut dhe shoqërinë civile; dhe fleksibilitetin për të zhvendosur fondet midis shtyllave gjeografike dhe tematike. Sipas propozimit, objektivat e detyrueshme të shpenzimeve për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave do të hiqen.¹⁴ Kritikët paralajmërojnë se këto ndryshime rrezikojnë të vendosin në plan të dytë zhvillimin afatgjatë të qëndrueshëm, përfshirë të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe mbështetjen për OShC-të që punojnë në këto çështje, në favor të interesave afatshkurtra.¹⁵ Ndërkohë, në BP, raportohet se financimi i ardhshëm për shoqërinë civile do të përqendrohet kryesisht në zbatimin e [planeve të rritjes](#). Duke qenë se këto plane pothuajse nuk adresojnë avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut, ekziston rreziku i dobësimit të mëtejshëm të qasjes së OShCG-ve në financim për punën e tyre.

Ndërkohë që aktivistët/et për të drejtat e grave dhe paqëndruesit vazhdojnë të ofrojnë dëshmi që ilustrojnë ndikimet dhe rëndësinë e mbështetjes fleksibël dhe institucionale, shumica e donatorëve po orientohen drejt financimeve më të kufizuara, afatshkurtra dhe të

¹¹ Lahiri, I., “[From Finland to the UK, European countries are slashing aid. What does it mean for climate funds?](#)” [Nga Finlanda në MB, vendet evropiane po shkurtojnë ndihmën: Çfarë do të thotë kjo për fondet klimatike?], *Euronews*, mars 2025; Sheldrick, M., “[Foreign Aid Is Shrinking—What Happens Next?](#)” [Ndihma e huaj po zvogëlohet - çfarë ndodh më pas?], *Forbes*, shkurt 2025; SEEK Development, “[Netherlands cuts NGO funding by US\\$1.1 billion](#)” [Holanda shkurton financimin për OJQ-të për 1.1 miliardë dollarë], *Donor Tracker*, nëntor 2024; Qeveria e Holandës, “[Letter of 20 February 2025 from the Minister for Foreign Trade and Development to the House of Representatives on International Development](#)” [Letër e datës 20 shkurt 2025 nga Ministri për Tregti të Jashtme dhe Zhvillim drejtuar Dhomës së Përfaqësuesve mbi zhvillimin ndërkombëtar], 2025.

¹² Alonso, J. A., “[The crisis of aid: ideal models for the future of development cooperation](#)” [Kriza e ndihmës: modele ideale për të ardhmen e bashkëpunimit për zhvillim], *Barcelona Centre for International Affairs*, tetor 2025.

¹³ Jones, A., “[A companion guide to the Global Europe instrument proposal](#)” [Një udhëzues shoqëruar për propozimin e instrumentit Global Europe], *European Centre for Development Policy Management*, korrik 2025, f. 1, 3.

¹⁴ Po aty., f. 2, 4, 5, 14.

¹⁵ Shih, si shembull, Jones, A.; CONCORD Europe, [Analysis of the European Commission's proposal for the EU's next Multiannual Financial Framework and the Global Europe Instrument](#) [Analiza e propozimit të Komisionit Evropian për Kornizën Shumëvjeçar Financiare të BE-së dhe instrumentin Global Europe], dhjetor 2025.

lidhura me projekte të veçanta.¹⁶ Për më tepër, BE-ja planifikon të reduktojë numrin e kontratave që po i menaxhon direkt, duke shpërndarë fondet përmes shteteve anëtare të BE-së dhe agjencive të OKB-së. Kjo rrit rrezikun nga ulja e fondeve dhe të kontratat afatshkurtra jo fleksibël, të cilat pengojnë aftësinë e OShC-ve për të ndikuar në mënyrë strategjike në ndryshim.¹⁷ Të gjitha këto trende janë veçanërisht shqetësuese për shkak të rritjes së lëvizjeve anti-gjinore dhe anti-drejtash.¹⁸ Hulumtimet e RrGK-së dokumentojnë se si akterë me burime të mëdha po i përhapin heshturazi narrativat anti-gjinore në Kosovë përmes seminareve gjysmë-private, hapësirave mediatike dhe kanaleve institucionale që forcojnë hierarkitë tradicionale gjinore dhe rekrutojnë të rinjtë. “Për mua, më shqetësuese janë komentet e të rinjve mbi fertilizimin e asistuar; veçanërisht djemtë e rinj tregojnë më shumë tendenca për të shkuar prapa dhe për t’u orientuar drejt konservatorizmit...”, tha një pjesëmarrës i hulumtimit që është aktiv në politikë. Një pjesëmarrës tjetër, përfaqësues i mediave, paralajmëroi se situatë e ndryshueshme e financimit rrezikon pavarësinë e OShC-ve, përfshirë OShCG-të, pasi ato përballen me një “rrezik të vazhdueshëm që aktivizmi i tyre të ndikohet nga agjendat e jashtme”.¹⁹ Kjo dinamikë ilustron një paradoks qendror të mbështetjes së shoqërisë civile: financimi i jashtëm është i domosdoshëm për mbijetesë, por mund të deformojë misionet dhe të krijojë varësi, duke vënë në provë autonominë që synon të promovojë.²⁰

Trendet e financimit në Kosovë

Në vitin 2024, të ardhurat mesatare të OShCG-ve në Kosovë ishin 83,122 euro, duke luhatur nga 0 deri në 1.2 milion euro. Vlen të theksohet se 20% e tyre nuk patën të ardhura fare. Në vitin 2025, të ardhurat ranë mesatarisht për 24%, duke arritur në 63,360 euro; 21% e OShCG-ve nuk patën të ardhura. Për vitin 2026, të ardhurat mesatare të pritshme të OShCG-ve ishin 41,347 euro, duke treguar një rënie të mëtejshme të mbështetjes financiare (rreth 50% më pak krahasuar me vitin 2024).

¹⁶ Vëzhgime nga punëtoritë dhe webinarët mbi peizazhin e financimit për organizimin feminist; Baekgaard, K., Rickenbrode, V. dhe Smith, J. M., *The Women, Peace and Security Survey: Reflections from Women Peacebuilders* [Anketa mbi gratë, paqen dhe sigurinë: Reflektime nga paqendërtueset], përmbledhje, Georgetown Institute for Women, Peace and Security, 2025, f. 5; Spasovska, B. dhe Bosilkova-Antovska, A., *Donor Support, Civic Space, and the Future of Civil Society in the Western Balkans* [Mbështetja e donatorëve, hapësira qytetare dhe e ardhmja e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor], BCSDN, 2025, f. 15; RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor*, 2020.

¹⁷ Shih RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor*, 2020. Në këtë raport theksohet se “OShCG-të shprehën shqetësim se OJQN-të dhe organizatat shumëpalëshe po ndërhyjnë në punën e tyre duke marrë përsipër çështje që historikisht janë udhëhequr nga OShCG-të, duke monopolizuar kështu financimin tashmë të kufizuar.” Një donator dypalësh tha: “Kemi parë shembuj të agjencive të OKB-së që konkurrojnë për fonde të vogla që mund të shkonin për OShC-të.” OShCG-të kanë shprehur shqetësime se kjo ka kontribuar në uljen e qasjes së tyre në financim. Madje, edhe kur këto fonde përfshinin nën-grante, OShCG-të nuk mendonin se ishin konsultuar apo angazhuar në përcaktimin e prioriteteve, ndërsa financimi ishte i vogël dhe afatshkurtër, duke penguar ndikimin e tyre.

¹⁸ AWD, *Where is the Money? An Evidence-Driven Call to Resource Feminist Organizing* [Ku janë paratë? Një thirrje e bazuar në prova për të mbështetur organizimin feminist] 2025, f. 19, 31.

¹⁹ Hulumtim i ardhshëm i RrGK-së mbi lëvizjen anti-gjinore dhe praninë, si dhe shtrirjen e saj në Kosovë dhe në rajon.

²⁰ Golub, S., *Beyond Rule of Law Orthodoxy: The Legal Empowerment Alternative* [Përtej paradigmes së sundimit të ligjit: alternativa e fuqizimit ligjor], Carnegie Endowment for International Peace, 2003, f. 41.

Në vitin 2025, 48% e OShCG-ve që kishin donatorë, kishin mesatarisht vetëm një donator, megjithëse disa kishin deri në tetë. Në kohën e anketës (vjeshta e vitit 2025 për pjesën më të madhe), 29% e OShCG-ve morën mbështetje nga ministritë, 19% nga komunat, 18% nga donatorët shumëpalësh (p.sh., BE, OKB, Banka Botërore), 16% nga OShC të tjera, 15% nga donatorë dypalësh si Austria, Suedia, Gjermania, Shtetet e

Grafiku 4. Donatorët aktualë të OShCG-ve
(Sipas % dhe # të OShCG-ve)



Bashkuara, Kanadaja dhe Zvicra, dhe 9% nga institucionet e tjera publike kosovare (shih Grafikon 4).²¹ Fondet për gratë, fatkeqësisht, nuk u përfshinë si opsion specifik në anketë, por u shtuan nga 7% e pjesëmarrësve; disa të tjerë ndoshta kanë marrë mbështetje nga fondet e grave, por mund të mos e kenë treguar këtë. Ndërkohë, 6% morën fonde nga fondacione private ndërkombëtare, 5% nga individë, 5% nga fondacione kosovare dhe 3% nga biznese në Kosovë.

Në të kaluarën, 81% e OShCG-ve raportuan se kishin marrë mbështetje nga Qeveria e Kosovës. Megjithatë, kontratat zakonisht zgjatnin mesatarisht më pak se pesë muaj, dhe pjesëmarrësit theksuan se financimi afatshkurtër krijonte vështirësi. Në vitin 2025, 31% e OShCG-ve morën mbështetje financiare nga komunat, 18% kishin të mbuluar shpenzimet për qiranë e zyrës, 17% kishin qasje falas në hapësira për aktivitetet e tyre, 5% për shërbime, 3% për shërbime komunale dhe 2% për ndihmë komunale në organizimin e aktiviteteve. Teksa shtrirja dhe lloji i mbështetjes ndryshon nga një komunë në tjetrën, kjo sinjalizon nevojën për përmirësim. Në fakt, drafti i strategisë për bashkëpunimi me shoqërinë civile i Qeverisë së Kosovës parasheh përmirësimin e rregulloreve dhe udhëzimeve për komunat, në mënyrë që të sigurojnë hapësira zyresh për OShC-të, gjë që mund të ulë ndjeshëm kostot operative.²²


Vetëm 25% e OShCG-ve raportuan se kishin ndonjë aktivitet që gjeneronte të ardhura. Nga këto, 10% shisnin produkte ushqimore, 9% produkte të punuara me dorë, 6% ofronin shërbime dhe 2% shisnin mallra të tjera. Kjo tregon se shumica e OShCG-ve mbeten ende shumë të varura nga financimi i donatorëve, megjithatë ekzistojnë mundësi për të siguruar fonde nga burime vendore.

²¹ Ndërkohë, gjatë dy viteve të fundit (që nga viti 2023), komunat ishin burimi më i përmendur i financimit (45% e OShCG-ve), pasuar nga ministritë (43%), donatorët shumëpalësh (32%), donatorët dypalësh (21%), fondacionet kosovare (26%) dhe OShC-të e tjera (20%). Një përqindje më e vogël, por e rëndësishme, e OShCG-ve ka marrë mbështetje nga bizneset private në Kosovë (15%), donatorët individualë (13%), institucionet e tjera shtetërore (11%) dhe fondacionet private (9%).

²² Zyra për Qeverisjes të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Strategjia e Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2026–2031 (draft), 2026, f. 30.

Grafiku 5. Fonde që OShCG-të kanë siguruar për të ardhmen

(% dhe # i OShCG-ve)



Në përgjithësi, 40% e OShCG-ve vunë re se financimi i tyre kishte rënë gjatë dy viteve të fundit, 38% thanë se kishte mbetur i njëjtë, ndërsa 22% raportuan rritje. Më tej, 17% e OShCG-ve raportuan se kishin humbur deri në tre donatorë gjatë dy viteve të fundit, ndërsa 17% thanë se nuk kishin asnjë donator për të humbur. Vlen të theksohet se 59% e OShCG-ve nuk kishin planifikuar të ardhura për vitin 2026 (Grafiku 5), kurse vetëm 9% kishin siguruar fonde për vitin 2027 e më tej.

OShCG-të thanë se u nevojiten mesatarisht 4,990 euro në muaj (59,886 euro në vit) për të **qenë funksionale**, me vlera që variojnë nga 0 euro për pesë OShCG deri në 40,000 euro për të tjerat. Edhe pse nevojat dallojnë ndjeshëm midis organizatave, nga 500 euro deri në 80,000 euro, OShCG-të raportuan se do t'u duheshin mesatarisht rreth 7,789 euro në muaj (93,469 euro në vit) për të **arritur plotësisht objektivat e tyre**. Vlen të theksohet se OShCG-të janë shumë të larmishme dhe se shumica e nevojshme ndryshon ndjeshëm në varësi të organizatës, shërbimeve, ekspertizës, fokusit dhe vendndodhjes.

Sfidat

OShCG-të thanë se sfidat kryesore që hasin janë mbështetja w pamjaftueshme nga komunitetet (47% e OShCG-ve),²³ mungesa e hapësirave fizike për funksionimin e tyre (35%), mungesa e stafit (32%) dhe situata aktuale politike, e cila pengon avokimin dhe përparimin në avancimin e barazisë gjinore. Në total, 23% e OShCG-ve nuk kanë hapësirë zyrash²⁴ Megjithatë, sfida kryesore për 90% të OShCG-ve mbetet mungesa e financimit, i cili do të mund të ndihmonte në adresimin e shumicës së sfidave të tjera.

Në nivel global, të dhënat tregojnë se mungesa e financimit bën që OShC(G)-të të shpenzojnë më shumë kohë duke aplikuar për fonde që sigurojnë vetëm mbijetesën, duke reduktuar kështu kohën e tyre të disponueshme në ofrimin e shërbimeve, avokimin, ndërtimin e koalicioneve dhe formësimin e politikave.²⁵ Në nivel vendor, OShCG-të e vogla, por shumë efektive, shpesh nuk kanë kohën dhe burimet njerëzore për t'u përballur me proceset e ndërlikuara dhe burokratike gjatë aplikimit për financim publik.²⁶ Ndërkohë që OShCG-të lokale janë veçanërisht efektive në përfshirjen e grupeve të marginalizuara, përfshirë gratë nga komunitetet pakicë dhe zonat rurale, falë lidhjeve të thella me komunitetin dhe legjitimitetit të tyre të besueshëm, ato hasin vështirësi në procedurat komplekse të aplikimit në gjuhën angleze; fondet shpesh u jepen në mënyrë disproporcionale organizatave më të mëdha dhe tashmë të

²³ Kur u pyetën "Si e përshkruani bashkëpunimin me komunën ku veproni?", 25% e OShCG-ve u përgjigjën se është "shumë i mirë", 48% "i mirë", 11% "i dobët", ndërsa 16% thanë se nuk ka bashkëpunim.

²⁴ Nga OShCG-të që kishin hapësira zyre, 40% i kishin të siguruar nga institucionet publike; 17% ishin pronare të hapësirave të tyre; 36% i merrnin me qira; ndërsa pjesa tjetër ndanin hapësirat me biznese, shtëpi private ose OShC të tjera.

²⁵ Shih si shembull: Friends of Europe, *Frontline Voices* [Zëra nga linja e parë], 2025, f. 11; Aleanca për Lëvizjet Feministe, rezultatet nga një anketë me anëtarë e cila synonte të informonte Strategjinë e re për Angazhimin e Anëtarësisë, prezantuar në një uebinar 27 janar 2026; RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor*, 2020, f. 93.

²⁶ Për më shumë informata, RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor*, 2020, "Studimi i rastit: Fondi i Grave të Kosovës"; RrGK, "Grante të vogla, ndryshime të mëdha: reflektim mbi arritjet e Fondit të Grave të Kosovës të RrGK-së", 31. korrik 2025.

konsoliduara.²⁷ Më tej, grantet mund të jenë tepër të mëdha për OShCG-të më të vogla për t'i shfrytëzuar plotësisht. Disa donatorë kanë provuar ta zgjidhin këtë duke financuar fondet për gratë, të cilat shpërndajnë grante më të vogla për të mbështetur më shumë organizata me bazë komunitetin (*grassroot*); iniciativa të tilla janë efektive, megjithëse të rralla.²⁸ Një shembull i tillë ishte Fondi i Grave të Kosovës i RrGK-së, më parë i mbështetur nga Kvinna till Kvinna, Austria, Suedia, BE-ja, Sigrid Rausing Trust, UN Women dhe UNFPA. Që nga viti 2026, ai është detyruar të pezullojë punën për shkak të mungesës së financimit. Ky Fond inovativ, i cili ndërtoi kapacitete duke përdorur metodologjinë “të mësarit nga përvoja” (*learning by doing*), ka avancuar në mënyrë efektive aftësitë e organizatave me bazë komunitetin dhe OShCG-të më të vogla për të aplikuar për grante nga donatorë të tjerë, veçanërisht nga qeveria, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë e tyre.²⁹ Megjithatë, mungesa e financimit të Fondit ka kufizuar hapësirën për OShCG-të e ndryshme në Kosovë, veçanërisht për ato më të vogla.³⁰

Humbja e financimit ka sjellë sfida të mëtejshme për OShCG-të, përfshirë rritjen e stresit (25% e OShCG-ve) dhe djegien profesionale të aktivistëve (14%). Për më tepër, 18% raportuan se janë detyruar të largojnë staf. Përtej humbjes së burimeve njerëzore për të realizuar aktivitetet, përballë ngarkesës së shtuar që lidhet me grumbullimin e fondeve shtesë, kjo mund të kontribuojë gjithashtu në humbjen e ekspertizës dhe njohurive që OShCG-të kanë punuar shumë për t'i zhvilluar. Ndërkohë, 8% e OShCG-ve u detyruan të mbyllin programe organizative, përfshirë ofrimin e shërbimeve.

“Po përballemi me vështirësi të mëdha financiare dhe po hasim vështirësi për të vazhduar aktivitetet për fëmijët me aftësi të kufizuara.”

- Aktiviste për të drejtat e grave

Megjithëse OShC-të, përfshirë edhe OShCG-të, janë partnerë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve dhe kjo njihet edhe nga legjislacioni ekzistues, financimi për këto shërbime mbetet afatshkurtër dhe joefikas, gjë që shpesh pengon ofrimin e shërbimeve thelbësore.³¹ OShCG-të raportuan disa sfida lidhur me financimin nga qeveria, përfshirë mungesën e fondeve të mjaftueshme (61%), afatet e shkurtra për zbatimin (38%), vonesat në transferimin e fondeve (28%) dhe procedurat burokratike (21%). Kosova ende nuk ka një kornizë të qëndrueshme kontraktimi për shërbimet e ofruara nga OShC(G)-të, pasi Udhëzimi Administrativ për partneritetin publik-privat nuk është finalizuar ose miratuar ende, dhe nuk ekziston një linjë buxhetore e dedikuar nga shteti për mbështetjen e OShC-ve.³²

Pavarësisht ekspertizës së tyre të njohur dhe faktit që korniza ligjor dhe ajo e politikave e Kosovës kërkon integrimin e perspektivës gjinore, rrallë Qeveria apo kontraktuesit që mbështesin reformat kanë angazhuar me pagesë OShCG-të si eksperte, zbatuese, monitoruese ose vlerësuese. Institucionet qeveritare rrallë alokojnë burimet për të kompensuar OShCG-të

²⁷ AWID, *Where is the Money? An Evidence-Driven Call to Resource Feminist Organizing*, 2025, p. 14; observations from RRGK participation in workshops and webinars on the funding landscape for feminist organising; RRGK members' statements vëzhgime nga pjesëmarrja e RrGK-së në punëtori dhe webinarë mbi peizazhin e financimit për organizimin feminist; deklarata të anëtarëve të RrGK-së.

²⁸ Miller, K. & Jones, R., *Toward a Feminist Funding Ecosystem* [Drejt një ekosistemi feminist të financimit], AWID, 2019, p. 42.

²⁹ Shih Main Level Consulting AG, *Kosovo Women's Network External Evaluation of the Kosovo Women's Network, its Strategy for 2015-2018 and Key Programs Contributing to this Strategy: Evaluation Report* [Vlerësimi i jashtëm i Rrjetit të Grave të Kosovës, Strategjia e saj për vitet 2015–2018 dhe programet kryesore që kontribuojnë në këtë strategji], 2018, f. 22; Vlerësimi i jashtëm i RrGK-së për mbështetjen e Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim, pritë të publikohet 2026.

³⁰ Diskutimet e RrGK-së me anëtarët e saj dhe akterët e tjerë.

³¹ Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Strategjia e Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2026–2031 (draft), 2026, f. 19.

³² Po aty.

për ekspertizën e tyre në procese të tilla si vlerësimet ex-ante e ndikimit gjinor, pjesëmarrja në grupe punuese për projektligje, ose mbështetja për integrimin e perspektivës gjinore në programet publike. Si rezultat, humbet mundësia për përmirësimin e cilësisë së politikave dhe për të siguruar financim të qëndrueshëm për OShCG-të.³³

Burimet alternative të financimit dhe strategjitë e qëndrueshmërisë

Është frymëzuese që 91% e OShCG-ve thanë se edhe nëse financimi nga donatorët ndalet, do të vazhdojnë punën e tyre. Shpirti i aktivizmit dhe përkushtimi ndërmjet OShCG-ve janë ndoshta cilësitë më të forta që mbështesin qëndrueshmërinë e tyre.

“Edhe pa projekte aktive, ne vazhdojmë t'i mbështesim gratë çdo muaj, duke u ndihmuar të kenë qasje në përfitime dhe shërbime thelbësore.”

Filantropia dhe vullnetarizmi mund të ndihmojnë OShCG-të të vazhdojnë aktivitetet e tyre. Kosova ka një histori të gjatë të vullnetarizmit dhe donacioneve, që nis nga vitet 90-ta dhe vazhdon edhe sot, veçanërisht përmes kontributeve të diasporës për mirëqenien e familjeve kosovare dhe në fusha të ndryshme zhvillimi. Megjithatë, kontribuesit potencialë shpesh nuk janë të vetëdijshëm për përfitimet e mbështetjes së OShC(G)-ve.³⁴ Për më tepër, kornizat rregullore që rregullojnë donacionet dhe vullnetarizmin kërkojnë përmirësim. Për shembull, individët dhe korporatat përfitojnë lehtësime tatimore për dhurimet ndaj OShC(G)-ve që zhvillojnë aktivitete me interes publik. Megjithatë, ligji për tatimin mbi të ardhurat e korporatave përdor një përkufizim më të ngushtë të “interetit publik” sesa koncepti më i gjerë i “dobisë publike” sipas ligjit për OShC-të, duke kufizuar qëllimet e pranueshme të donacioneve vetëm për aktivitete humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, për mbrojtjen e mjedisit dhe ato sportive. Si rezultat, donacionet për kauza si të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave nuk mund të zbriten nga tatimet për donatorët e korporatave, edhe pse njihen si kontribute ndaj “dobisë publike” sipas ligjit për OShC-të.³⁵ Një ligj specifik për sponsorizime ofron zbritje më të larta për donacionet, por vetëm për sportin, kulturën dhe të rinjtë.³⁶

Megjithëse, OShC(G)-të në Kosovë zakonisht përjashtohen nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), përjashtimet nga tatimi për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve (dhurime në natyrë) vlejnë vetëm për programet humanitare dhe të rindërtimit. Ky përjashtim i kufizuar nuk përputhet me praktikën e BE-së, ku përjashtimet më të gjera mbulojnë përgjithësisht aktivitetet jo-fitimprurëse. Megjithatë, donacionet monetare zakonisht nuk i nënshtrohen TVSH-së, por mbetet e paqartë nëse kjo vlen për disa forma të grumbullimit të fondeve, si donacionet përmes SMS-ve.³⁷ Paqartësitë dhe pasaktësitë ligjore të tilla mund të krijojnë stimuj joproporcionalë për lloje të caktuara të mbështetjes dhe mund të paraqesin pengesa për OShC(G)-të në përpjekjet e tyre për të siguruar burime.

Programi i vullnetarizmit i RrGK-së, ndër të tjera, tregon një interes të madh për vullnetarizmin. Megjithatë, mungesa e një kornize ligjore të plotë dhe të qartë kufizon aftësinë e OShCG-ve për ta shfrytëzuar plotësisht këtë potencial. Një ligj për vullnetarizmin është iniciuar, por ende nuk është finalizuar ose miratuar. Dispozitat ekzistuese përjashtojnë vullnetarët e

³³ Shih RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor*, 2020.

³⁴ Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Strategjia e Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2026–2031 [draft], 2026, f. 18.

³⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave*, 2019, neni 11; Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare*, 2019, neni 37.

³⁶ KCSF, *Analiza e kornizës ligjor dhe rregullore për filantropinë në Kosovë*, 2024, f. 16.


³⁷ Meqenëse Ligji për TVSH-në nuk parasheh përjashtim specifik nga tatimi për shërbimet e telekomunikacionit, donacionet e bëra përmes SMS-ve ose telefonatave mund të trajtohen si shërbime të tatueshme dhe, për rrjedhojë, t'i nënshtrohen TVSH-së (Po aty., f. 14, 19).

rritur, vendosin kërkesa kufizuese, si numri minimal i orëve të angazhimit, dhe nuk ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse e të institucionalizuar.³⁸

RrGK pyeti OShCG-të për opsionet e tyre në rastet emergjente. Kur u pyetën nëse mund të vazhdonin punën pa zyra, 47% thanë se do të punonin nga shtëpia, duke treguar një nivel të lartë adaptueshmërie. Të tjerët thanë se do të punonin në hapësira alternative, si objektet publike (26%), zyrat e një OShC-je tjetër (11%) ose shkollat (6%). Në këtë mënyrë, ndarja e hapësirave midis OShCG-ve mund të zvogëlojë ndjeshëm kostot operative. Kur u pyetën për gatishmërinë për të ndarë hapësirat e punës me OShC-të e tjera në komunën e tyre, 45% shprehën gatishmërinë për një bashkëpunim të tillë. Të tjerët, 48%, u përgjigjën “ndoshta”, duke përmendur kufizimet e hapësirave për të ndihmuar ose pranuar të tjerët në këto hapësira. Këto rezultate tregojnë për një frymë solidariteti ndër shumë OShCG, të cilat janë të gatshme të mbështesin njëra-tjetrën.

Nevojat e OShCG-ve

OShCG-të identifikuan disa nevoja të tyre (Grafiku 6). Shumica (88%) e konsideruan mbështetjen financiare si nevojën më të madhe. Disa thanë se kanë nevojë për trajnime dhe zhvillim kapacitetesh (50%), mbështetje në menaxhimin e stafit ose të vullnetarëve (27%), mbështetje teknike, si për Teknologjinë e Informacionit ose zhvillimin e faqeve të internetit (21%), mbështetje për fushata ndërgjegjësimi dhe avokimi (18%) dhe rrjetëzim me OShC-të e tjera (17%). Ato gjithashtu kërkuan ndihmë për qasje në burime (17%), monitorim dhe vlerësim (12%), si dhe zhvillim politikash dhe asistencë ligjore (11%).³⁹



OShCG-të në mënyrë specifike kërkuan mentorim dhe trajnime mbi tema të tilla si sigurimi i fondeve dhe përgatitja e propozimeve për projekte (35%), strategjitë alternative të grumbullimit të fondeve (19%), avokimi dhe lobimi (17%), menaxhimi financiar (16%) dhe komunikimi publik (15%). Tema të tjera të kërkuara përfshijnë qeverisjen organizative (5%), monitorimin dhe vlerësimin (4%), përdorimin e kompjuterëve dhe mjeteve digjitale (3%) dhe marrëdhëniet me publikun (2%). Edhe pse RrGK-ja ka ofruar më parë trajnime dhe mentorim mbi këto tema, përfshirë përmes Fondit të Grave të Kosovës, kërkesat e OShCG-ve tregojnë nevojën për mbështetje të vazhdueshme, veçanërisht përballë sfidave të reja dhe lëvizjes së stafit.

³⁸ Sheremeti, C., “[A po i ndihmojnë realisht politikat e Kosovës atyre që duan të punojnë si vullnetarë?](#)”, Kosovo 2.0, 16 korrik 2019.

³⁹ Kur u pyetën në mënyrë specifike se si RrGK mund t'i mbështeste më mirë, shumica e OShCG-ve kërkuan mbështetje financiare ose grante (88%), trajnime dhe zhvillim të kapaciteteve (47%), ndihmë me staf ose vullnetarë (27%), mbështetje teknologjike (21%), mentorim dhe trajnime (19%), fushata ndërgjegjësimi dhe avokimi (18%), qasje në burime (17%) dhe rrjetëzim me OShC-të e tjera.

Kur u pyetën se cili lloj financimi do të ishte më i përshtatshëm për organizatën e tyre, OShCG-të shprehën një preferencë të fortë për grante afatgjata (82%) dhe mbështetje institucionale (57%), duke theksuar rëndësinë e financimeve të qëndrueshme dhe të parashikueshme. Ndërkohë, 32% kërkuan mbështetje për projekte specifike dhe 27% favorizuan forma fleksibile financimi që lejojnë përdorimin adaptiv të burimeve.

Shpenzimin kryesor që OShCG-të kanë për të arritur objektivat e tyre është stafi, sipas 86% të OShCG-ve. Kjo nuk është befasuese, pasi planifikimi, zbatimi, hulumtimi, avokimi, ndërgjegjësimi, zhvillimi i kapaciteteve, ofrimi i shërbimeve, monitorimi dhe vlerësimi kërkojnë kryesisht burime njerëzore. Në total, OShCG-të raportuan se kanë nevojë për të paktën 415 punonjës me orar të plotë dhe 274 punonjës me orar të pjesshëm për të zbatuar aktivitetet e tyre dhe për të shërbyer grupet e synuara. Shpenzime të tjera përfshijnë shërbimet komunale (67%), rimbursimin e transportit (65%), ushqimin dhe pijet për pjesëmarrësit (58%), qiranë (46%), shtypjen e materialeve (42%) dhe hapësirat për takime (30%).

Përfundimi

OShCG-të kosovare janë shumë të larmishme dhe kanë nevoja të ndryshme. Megjithatë, ato ndajnë një vijë të përbashkët që karakterizohet nga qëndrueshmëria dhe përkushtimi për avancimin e të drejtave të grave, demokracisë dhe drejtësisë sociale. Të dhënat tregojnë një ulje të financimeve të disponueshme për OShCG-të dhe një të ardhme të pasigurt. Duke pasur parasysh shërbimet dhe aktivitetet jetike që ofrojnë, mungesa e financimit mund t'i vë në rrezik persona me aftësi të kufizuara, pakicat, të rinjtë, të moshuarit, të mbijetuarit/at e dhunës dhe grupe të tjera, duke i ekspozuar ndaj dhunës, varfërisë, varësisë, sëmundjeve dhe mosangazhimit në jetën publike. Mungesa e financimit kërcënon gjithashtu përparimin e politikave dhe reformave gjithëpërfshirëse dhe të përqendruara tek njerëzit, të cilat janë thelbësore për anëtarësimin e Kosovës në BE.

Në të kaluarën, Qeveria ka mbështetur shumë OShCG, edhe pse kryesisht për një afat të shkurtër. Ekzistojnë mundësi për zgjerimin dhe përmirësimin e kësaj mbështetjeje, veçanërisht për ofruesit e shërbimeve dhe ekspertizën e kontraktuar. Ndërkohë, OShCG-të me fokus në avokim, përfshirë organizatat mbikëqyrëse dhe qendrat e hulumtimit (think tank), ende kanë nevojë për mbështetje të huaj për të ruajtur pavarësinë dhe për të siguruar llogaridhënien nga qeveria, veçanërisht derisa të krijohen mekanizma të pavarur financimi jo-politik në Kosovë. Filantropia dhe vullnetarizmi mund të lehtësojnë punën e OShCG-ve, nëse ulen pengesat ligjore dhe rregullatore. Pa adresimin e këtyre kufizimeve, Kosova dhe partnerët e saj ndërkombëtarë rrezikojnë të humbasin mbështetjen e organizatave që kanë qenë thelbësore për avancimin e barazisë gjinore, të drejtave të njeriut, proceseve shtetndërtuese dhe reformave të përputhura me standardet e BE-së.

Rekomandimet

Rekomandimet burojnë nga gjetjet e këtij hulumtimi dhe bazohen në studime të mëparshme të RrGK-së dhe akterëve të tjerë në nivel global mbi financimin e lëvizjeve të grave.⁴⁰

Për Qeverinë e Kosovës

- Të merret me urgjencë përgjegjësia për alokimin e fondeve të mjaftueshme që të mbështeten **plotësisht shërbimet e specializuara** të OShCG-ve, veçanërisht në mungesë të shërbimeve shtetërore, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar te trajtimi i dhunës me bazë gjinore sipas Konventës së Stambollit, mbështetja e personave me aftësi të kufizuara, kujdesi

⁴⁰ Për më shumë hollësi dhe dëshmi, shih këto publikime më të gjera, të cilat janë ende aktuale: Miller, K. dhe Jones, R., [Toward a Feminist Funding Ecosystem](#) [Drejt një ekosistemi feminist të financimit], AWID, 2019; RrGK, [Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor](#), 2020; dhe AWID, [Watering the Leaves, Starving the Roots](#) [Ujtitja e gjetheve, tharja e rrënjëve], 2013.

për të moshuarit, shëndeti mendor, mbijetuarit/at e dhunës seksuale dhe shërbime të tjera. Duhet të krijohen **linja të përhershme buxhetore** për këto shërbime, bazuar në nevojat e evidentuara, duke përdorur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor çdo vit për të rishikuar kostot dhe për të udhëhequr alokimet adekuate sipas ligjit për barazinë gjinore.

- Të finalizohet dhe miratohet udhëzimi administrativ për partneritetin publiko-privat me kontributin e OShCG-ve, duke mundësuar **kontraktimin social afatgjatë** të tyre si zbatuese të programeve të financuara publikisht. Kjo do të ulë barrën administrative për Qeverinë dhe OShC-të.
- Të përfshihet në Programin e ardhshëm të Kosovës për Barazinë Gjinore 2025–2035 zotime dhe objektiva të qarta për financimin qeveritar të OShCG-ve të ndryshme përmes Agjencisë për Barazi Gjinore. Të sigurohet financim afatgjatë dhe i qëndrueshëm përmes proceseve transparente të dhënies së granteve, të zhvilluara së bashku me OShCG-të dhe të bazuara në nevojat e tyre.
- Të zbatohen zotimet për integrimin e perspektivës gjinore në ligje, politika, programe dhe buxhete, duke përfshirë përdorimin e duhur të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Të zbatohen gjithashtu kërkesat për vlerësime të ndikimit gjinor *ex ante* dhe *ex post*. Të ndahet buxheti për të kontraktuar ekspertët që të mbështesin Qeverinë në këto detyra. Të sigurohet prokurim transparent i ekspertëve që ofrojnë këtë mbështetje, në mënyrë që OShCG-të të mund të aplikojnë si eksperte dhe vlerësuese të pavarura (jo vetëm individë dhe biznese).
- Të përmirësohet korniza ligjore dhe mjedisi mundësues për zhvillimin e OShC(G)-ve të ndryshme që të grumbullojnë fonde nga individë dhe biznese. Të harmonizohet ligji për tatimin mbi të ardhurat e korporatave me ligjin për OShC-të, duke zgjeruar përkufizimin e “interesit publik” për ta përputhur me përkufizimin e “dobisë publike” sipas ligjit për OShC-të dhe duke siguruar që donacionet për iniciativat për të drejtat e grave të mund të zbriten nga tatimi për donatorët e korporatave. Të zgjerohen përjashtimet nga pagesa e TVSH-së për donacionet në natyrë përtej programeve humanitare dhe të rindërtimit, duke sqaruar gjithashtu aplikimin e këtyre përjashtimeve edhe për forma alternative të grumbullimit të fondeve, si donacionet përmes SMS-ve. Të mundësohen stimuj tatimorë të barabartë për donacionet për të drejtat e grave, në përputhje me zbritjet ekzistuese për sportin, kulturën dhe të rinjtë.
- Të krijohet një fond kombëtar i filantropisë si fond publiko-privat me mekanizëm adaptiv, i mbështetur nga Qeveria, për të nxitur donacione bamirësie në shkallë të gjerë.
- Të finalizohet ligji për vullnetarizmin dhe të sigurohet që ai të mos vendosë kufizime moshe ose detyrim për numër minimal orësh për vullnetarët. Të garantohet gjithashtu që ky ligj të njohë punën vullnetare si përvojë formale pune.
- Të sigurohet ofrimi transparent dhe i drejtë i fondeve publike. Të vendosen masa mbrojtëse për të minimizuar rrezikun nga keqpërdorimi, si thirrjet e hapura me kritere të qarta për përzgjedhje, angazhimi i vlerësuesve të pavarur dhe funksionimi i mekanizmave të besueshëm të ankesave.
- Të sigurohet monitorimi i fondeve publike dhe vlerësimi i ndikimit përmes të dhënave të ndara sipas gjinisë, vendndodhjes rurale/urbane, moshës, etnisë dhe aftësisë së kufizuar.
- Të thjeshtohen proceset administrative për OShCG-të që aplikojnë për financime publike, duke reduktuar dokumentacionin e panevojshëm dhe duke digjitalizuar procedurat.
- Të bëhen të dhënat mbi shpenzimet e ofruara për shoqërinë civile të rregullat dhe të qasshme për publikun, të ndara sipas gjinisë, në përputhje me ligjin për barazinë gjinore.

Donatorët ndërkombëtarë

- Të vazhdohet me ndarjen e fondeve afatgjata dhe fleksibël, veçanërisht për organizatat *think tank*, ato mbikëqyrës dhe OShCG-të që kanë si fokus avokimin, në mënyrë që ato të mbeten të pavarura në kërkimin e llogaridhënies nga qeveria dhe të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazinë gjinore, qeverisjen e mirë, demokracinë dhe një shoqëri civile të pavarur.
- Të përdoret ajo që AWID e ka quajtur “koktej modalitetesh” në një [“ekosistem dinamik financimi”](#), i cili përfshin mbështetje institucionale, grante projektsh dhe nën-grante për OShCG-të më të vogla, duke adresuar nevojat e OShCG-ve të ndryshme.
- Të forcohet bashkëpunimi me fondet për gratë për të ndarë grante për OShCG-të më të vogla, pasi dëshmitë ndërkombëtare tregojnë për efikasitetin dhe efektivitetin e tyre.
- **Financimi afatgjatë dhe mbështetja institucionale** janë thelbësore për kontributin në veprimet strategjike, për sigurimin e **fleksibilitetit** në situata jostabile politike, për rritjen e kapaciteteve, qëndrueshmërinë organizative dhe arritjen e ndikimit që kërkon angazhim afatgjatë.
- Të sigurohet dialog me OShCG-të mbi nevojat e tyre për financim, mënyrat për t'i adresuar këto nevoja dhe metodat më të mira për avancimin e barazisë gjinore, duke bashkëkrijuar modalitetet e financimit.
- Të planifikohen fonde të ardhshme specifiku për avancimin e barazisë gjinore dhe në mënyrë të qartë për OShCG-të, duke i prioritetizuar ato fonde për adresimin e pabarazive të mëdha të identifikuara përmes analizave gjinore, siç parashikohet nga Agjenda GPS.
- Të ndahen fonde për mbështetjen e OShCG-ve, duke përfshirë ndarjen e kostove ose duke hequr këto kërkesa. Në rast se kërkohen, të lejohet që kontributet e dokumentuara në natyrë të llogariten si pjesë e ndarjes së kostove, duke njohur kontributet e konsiderueshme vullnetare dhe në natyrë të aktivistëve.
- Të përmirësohet koordinimi i donatorëve dhe strategjia e përbashkët për avancimin e barazisë gjinore. Kur është e mundur, të përdoret financimi dhe raportimi i përbashkët me donatorë të tjerë, për të minimizuar barrën administrative.
- Të kërkohet analizë gjinore ex ante e obligueshme dhe integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha programet, në përputhje me kriteret e shënjesit gjinor të Komitetit të Ndihmës për Zhvillim të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (KNZh i OBZHE-së). Të kontraktohen OShCG-të dhe aktivistët si ekspertë për të ofruar këtë mbështetje, duke i kompensuar ata për ekspertizën e tyre.
- Të përmirësohen sistemet për përcjelljes së shpenzimeve për barazinë gjinore, të drejtat e grave, gratë dhe vajzat, si dhe për mbështetjen direkte të OShCG-ve. Duke përdorur praktikatat më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, të përmirësohet matja e fondeve të alokuara dhe të shpenzuara.
- Të kërkohet nga qeveritë përfituese që të përfshijnë perspektivën gjinore në programet e financuara nga burime të jashtme dhe të zbatojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, si pjesë e marrëveshjeve të financimit dhe mbështetjes direkte buxhetore.

Për Bashkimin Evropian

- Siç rekomandohet nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore, të vendoset një detyrim për shpenzime për barazinë gjinore, zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve për integrimin e perspektivës gjinore në KShF-në dhe proceset buxhetore, si dhe për të kryer analiza të buxhetimit gjinor për të vlerësuar ndikimin e të gjitha programeve të financimit për barazinë gjinore.
- Të vendosen kërkesa të detyrueshme për avancimin e barazisë gjinore përmes financimeve të jashtme. Të sigurohet që rregulloret për të gjitha instrumentet: 1) kërkojnë vlerësime ex ante të ndikimit gjinor për të gjitha veprimet dhe që këto analiza të shërbejnë për përcaktimin e objektivave, treguesve dhe qëllimeve të qarta për barazinë gjinore sipas kriteve të

shënjesit gjinor të KNZh-së së OBZHE-së; 2) planifikojnë fonde të dedikuara për barazinë gjinore, siç veprohet për mjedisin; 3) bëjnë të detyrueshëm buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; 4) kërojnë që të gjitha vlerësimet të shqyrtojnë efektet mbi barazinë gjinore; dhe 5) kërkojnë përcjellje dhe raportim të rregullt mbi shpenzimet reale për barazinë gjinore, gratë dhe vajzat, si dhe OShCG-të.

- Për të ndërtuar në mënyrë efektive kapacitetet e OShC(G)-ve në vendet e zgjerimit për menaxhimin e fondeve të BE-së, të përdoren kushtëzime në kriteret e kualifikueshmërisë për të gjithë mbështetjen e programit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile (*EU Civil Society Facility*), duke siguruar që fondet po i mbështesin **vetëm** OShC-të **lokale** të regjistruara në vendet përfituese dhe me përvojë të vërtetuar në këto vende.
- Të parashikohen fonde vjetore për avancimin e barazisë gjinore në sektorët e identifikuar përmes analizave gjinore. Kjo duhet të jetë përtej planeve të rritjes, të cilat zakonisht janë neutrale nga aspekti gjinor.
- Si pjesë e mbështetjes direkte buxhetore për qeveritë përfituese (përfshirë edhe ato që lidhen me Planin e Rritjes), të kërkohen gjithmonë tregues që matin përparimin në avancimin e barazisë gjinore.
- Përmes dialogut politik lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, të nxiten veprimet e qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore, përfshirë edhe përmes alokimit të burimeve për OShCG-të.
- Të mbështetet Kosova në krijimin e një financimi më të qëndrueshëm për ofruesit e shërbimeve të OShCG-ve që ndihmojnë personat që kanë përjetuar dhunë.⁴¹ Në mënyrë të ngjashme, të inkurajohet qeveria të alokojë fonde për kontraktimin e shërbimeve të tjera të OShC(G)-ve me ekspertizë, si ato për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe të rinjtë, ndër të tjerat.

⁴¹ RrGK ka zhvilluar një metodologji dhe pritjet të publikojë një hulumtim (2026) që vlerëson kostot e ofrimit të shërbimeve të specializuara në lidhje me Konventën e Stambollit, i cili mund të shërbejë si bazë për përlogaritjen e kostove.



Fuqizimi i Lëvizjes Feministe

Bashkë-financuar nga:

